Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**Zyra e Kryetarit**

**Nr.400/01-18631/20**
**Kaçanik; 11.08.2020**

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | ZYREN KOMBETARE TE AUDITIMIT ZKA – DREJTORIT Z.BESNIK OSMANI |
| CC: | ZYREN E KUVENDIT KOMUNAL – KRYESUESIT Z. KEMAJL MËRSELI |
| NGA/OD/FROM: | Besim Ilazi – Kryetar Komune-ZKA |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Dorëzimi i Planit të Veprmit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2019 |

***Të nderuar,***

Bashkëngjitur me këtë shkresë po iu dergojmë Planin e Veprmit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31.12.2019 për shqyrtim dhe diskutim në seancën e ardhshme e cila do të zhvillohet nga Asambleja Komunale.

***Me respekt;***

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**Për Zyrën Kombëtare të Auditimit**
**Nga z.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës**

## PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV'2019**

| Nr. | Komponenta e Auditimit (Kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë | Zyrtari/ët përgjegjës | Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Opinioni i Auditimit** | **Theksimi i çështjes:**<br><br>Ne dëshirojmë të | Kryetari i Komunës së Kaçanikut është përgjegjës për | Lëndët gjyqësore-përmbarimore në momentin që arrijnë në MF- | Zyra e Kryetarit ne kordinim të ngushtë me | Janar – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes:**<br><br>Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2019 ***paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*** në të gjitha aspektet materiale. | tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pagesat e realizuara nga Thesari në emër të komunës në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore, në vlerë 153,425€ janë paguar dhe regjistruar në kategoritë jo adekuate ekonomike. | përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo | Departamentin e Thesari bëhen të ekzekutueshme financiarisht. Në këto raste Komuna përkatësisht Drejtoria e Financave nga MF-Departamenti i Thesarit pranon një email ku kërkohet që brenda vetëm 60 minutave të dërgojmë propozim se nga ku mund të tërhiqen mjetet ne dobi te përmbaruesit. Kur shumat e këtyre lëndëve janë të larta, ne nuk kemi mundësi ti dërgojmë propozime konkrete për tërheqje të mjeteve për kompensim të tyre përshak të mungesës së buxhetit, prandaj me automatizëm Thesari ekzekuton lëndët sipas gjendjes momentale | Drejtorinë e Financave dhe Drejtoritë tjera komunale si dhe Zyrën ligjore komunale. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore. | të mjeteve të lira buxhetore. Nga ky veprim rezulton keqklasifikimi i shpenzimeve, andaj komunës më shumë i mbetet të angazhohet në mbrojtjen ligjore ndaj lëndëve të ndryshme para se ato të jenë preliminare, ndërsa në momentin që marrin formën e prerë, mundësitë për shpenzim të këtyre lëndëve sipas kodeve adekuate të shpenzimeve, janë të pamundhsme, sepse Komuna nuk ka potencial financiarë për planifikime të tilla. | | | |
| 1 | **Çështja A1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve** | **Gjetja:** Komuna kishte paguar dhe regjistruar shpenzime nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve. Keto | Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate | Lëndët gjyqësore-përmbarimore në momentin që arrijnë në MF-Departamentin e Thesari bëhen të ekzekutueshme financiarisht. Në | Zyra e Kryetarit ne kordinim të ngushtë me Drejtorinë e Financave dhe Drejtoritë tjera komunale si | Janar – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pagesa kanë të bëjnë me:<br>Pagesat per Investime kapitale, për shpronësim të tokës në vlerë prej 119,872€s, të ekzekutuara nga thesari me vendime gjyqësore/përmbarimore nga kategoria Mallra dhe Shërbime; dhe Pagesa për paga me vlerë 33,553€, kompensim ndaj punonjësit të larguar padrejtësisht nga puna, dhe ishte paguar nga Investimet Kapitale.<br>Këto pagesa janë bërë nga kategoritë jo adekuate për shkak të mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.<br>Ne, po ashtu, kemi identifikuar dy pagesa me vlerë | të buxhetit dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet me përpikëri sipas kodeve ekonomike adekuate. Po ashtu të gjitha obligimet duhet të paguhen me kohë në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore. | këto raste Komuna përkatësisht Drejtoria e Financave nga MF-Departamenti i Thesarit pranon një email ku kërkohet që brenda vetëm 60 minutave të dërgojmë propozim se nga ku mund të tërhiqen mjetet ne dobi te përmbaruesit. Kur shumat e këtyre lëndëve janë të larta, ne nuk kemi mundësi ti dërgojmë propozime konkrete për tërheqje të mjeteve për kompensim të tyre përshak të mungesës së buxhetit, prandaj me automatizëm Thesari ekzekuton lëndët sipas gjendjes momentale të mjeteve të lira buxhetore. Nga ky veprim rezulton keqklasifikimi i | dhe Zyrën ligjore komunale | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | totale 6,275€ që kishin të bënin me shpenzimet e varrimit, e të cilat ishin realizuar nga mallrat dhe shërbimet, përderisa natyra e shpenzimeve ishte subvencione dhe transfere. Kjo ka ndodhur si shkak i planifikimit/buxhetimit të mjeteve nga kategoria e mallrave. | | shpenzimeve, andaj komunës më shumë i mbetet të angazhohet në mbrojtjen ligjore ndaj lëndëve të ndryshme para se ato të jenë preliminare, ndërsa në momentin që marrin formën e prerë, mundësitë për shpenzim të këtyre lëndëve sipas kodeve adekuate të shpenzimeve, janë të pamundhsme, sepse Komuna nuk ka potencial financiarë për planifikime të tilla. | | | |
| 2 | **Çështja A2 - Dobësi në dhënien në shfrytëzim të pronës komunale** | **Gjetja:** Komuna nuk ka procedura të parapara me akte nënligjore për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme komunale. Ndërsa kishte dhënë me | Kryetari duhet të siguroj hartimin e procedurave të shkruara për dhënien e pronave në shfrytëzim afatshkurtër, siç e parasheh ligji. Po ashtu para se të nënshkruhen kontratat e reja të | Per dhënien e pronave afatshkurter ne shfrytezim do te hartohet rregullorja e brendshme adekuate, permes se cilës do te veprohet më tutje.<br><br>Rregullorja do te trajton edhe qeshtjen | Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mjedisit. | Gusht – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | qira pronat komunale për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2019, duke vazhduar kontratat paraprake pa procedura. Kjo është evidentuar në 4 nga 5 mostrat e testuara. Vlen të ceket se kontratat janë nënshkruar edhe pse qiramarësit nuk kishin kryer obligimet paraprake. Sipas pohimeve të drejtorisë së urbanizmit, këto prona komunale janë dhënë në shfrytëzim që nga viti 1997 dhe kanë vazhduar deri më tani me vazhdim të kontratave. | gjithë qiramarrësit/shfrytëzuesit e pronave duhet ti kryejnë obligimet paraprake kontraktuale. | e barazimeve financiare mes shfrtyezueseve te pronave publike dhe komunes. | | | |
| 3 | **Çështja B1 - Mangësi në evidencat për pronat me qira** | **Gjetja**<br>Drejtoria e urbanizmit, mban evidencë për pronat e dhëna me qira, mirëpo ato | Kryetari duhet të siguroj që drejtoria e urbanizmit dhe zyrtari i të hyrave të kryejnë | Drejtoria e Urbanizmit do te bene perditesimin e shenimeve rreth inkasimit te qerasë per pronat publike, | Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mjedisit dhe | Janar – Dhjetor 2020 | Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nuk janë të plota për të siguruar se të gjitha vlerat janë regjistruar saktë, pasi që dallojnë të hyrat e regjistruara në freebalance me ato të evidentuara në regjistrin e brendshëm. Po ashtu nuk kishte kartela financiare për pronat e dhëna me qira.<br>Kjo ka ndodh pasi pagesat e inkasuara përmes përmbaruesit privat nuk janë evidentuar në regjistrin e brendshëm, në mungesë të informatave nga zyrtari i të hyrave. Gjithashtu nuk ishin kryer barazimet mujore mes zyrtarit të të hyrave dhe drejtorisë, ku do të mund të evidentoheshin këto mangësi. | barazime mujore të evidencave. Është e nevojshme që për çdo pronë të lëshuar me qira të mbahen evidenca/kartela financiare. | kartelat e krijuara financiare do te paraqesin nje pamje te drejte te saldove.<br><br>Konform rregullores se Thesarit do te behen barazime te rregullta mujore mes secilit zyrtarë që eshte pergjegjes per inkasim te llojeve te ndryshme te te hyrave dhe zyrtarit komunal prane drejtorise se financave, i cili eshte pergjegjes per regjistrim dhe barazim te te hyrave. | Zyrtar i regjistrimit te te hyrave. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | **Çështja C1 - Mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta (MShV)** | **Gjetja:** Sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcaktohet që emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (MShV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Komuna gjatë vitit 2019 kishte të angazhuar me MShV 19 punonjës. Edhe pse ishin përdorur procedura të thjeshta rekrutimi, 12 prej tyre ishin nga vitet paraprake kryesisht nga viti | Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. | Sikurse deri me tani, do te vazhdohet me respektimin e procedurave ligjore per angazhim te stafit per sherbime te veqanta.<br><br>Angazhimet e tilla te stafit do te behen vetem per pune specifike. | Zyra e Kryetarit përmes Zyrës së Personelit. | Janar – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2014. Këto angazhime ishin kryesisht për pozita jo specifike të punës9, një dukuri e tillë sipas menaxherit të personelit ka ndodhur për shkak të nevojës për angazhimin e stafit për realizimin e objektivave shtesë të komunës. | | | | | |
| 5 | **Çështja A3- Dobësi në menaxhimin e subvencioneve** | **Gjetja**<br>Te thirrja për aplikim në "Fushën e kulturës rinisë dhe sportit" nuk ishin kërkuar kritere të matshme dhe specifike për përzgjedhjen e përfituesve potencial. Kjo ka bërë që pothuajse të gjithë aplikantët të plotësojnë kriteret, andaj zyrtarët nuk kanë arritur të na dëshmojnë në tri raste se si është bërë vlerësimi si | Kryetari duhet të vendosë kontrolle shtesë në procesin e ndarjes së subvencioneve, për të siguruar se kriteret në thirrjet publike për aplikim të jenë specifike dhe të qarta, dhe të sigurohet se subvencionimi paraprihet me marrëveshje e cila bën të mundur edhe monitorimin e shpenzimit të | Ndarja e subvencioneve do te behet konfor rregulloreve perkatese, kujdes me i veçant do ti kushtohet percaktimit te kritereve me specifike per ndarjen e tyre. | Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe secila Drejtori e cila shperndan subvencione. | Janar – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe nuk na janë ofruar procesverbalet nga komisioni për vlerësim siç është e paraparë në rregulloren e brendshme të komunës | këtyre mjeteve. | | | | |
| 6 | **Çështja A4 - Dobësi në procesin e prokurimit** | **Gjetja:** Gjatë testimit të 5 mostrave të pajtueshmërisë kemi vërejtur se në dy raste komuna kishte zhvilluar aktivitete të prokurimit që nuk ishin të përfshira në planin e prokurimit dhe nuk e kishte njoftuar AQP-në sipas rregullave. Vlen të ceket se për projektin "Ndërtimi i tereneve sportive" punët vetëm kishin filluar dhe nuk | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjtiha aktivitetet jashtë planit të prokurimit do të njoftohen organet kompetente, si dhe të përgatiten projektet ekzekutive si pjesë e specifikave teknike të projekteve, në mënyrë që të lehtësohet edhe realizimi i tyre konform kontratave. | Zyra e Prokurimit do te beje njoftimet me kohë në AQP.<br><br>Inicimi dhe realizimi i procedurave per secilin projet do te behet ne baze te projekteve te hartuara e jo paramasave dhe parallogarive. | Zyra e Kryetarit permes Zyres se Prokurmit. | Janar – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ishin realizuar, pasi projekti nuk ishte përfunduar brenda afateve kohore të parapara me marrëveshje dhe kontratë.<br>Në tre projekte për punën komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit vetëm në bazë të paramasës dhe parallogarisë. | | | | | |
| 7 | **Çështja B2 – Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në PFV** | **Gjetja:**<br>Komuna nuk kishte aprovuar rregullore apo procedurë të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare ashtu siç kërkohet me rregullën financiare;<br>Komuna kishte formuar komisionin për | Kryetari duhet të inicojë aprovimin e rregullave të brendshme për menaxhimin e pasurive për të qartësuar secilin aktivitet që lidhet me menaxhimin e pasurive. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e | Menaxhimi i pasurise do te behet konform rregulloreve te brendshme si dhe rregullave te Thesarit. | Zyra e Kryetarit permes Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe me Drejtorinë e Financave. | Janar – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | inventarizim/vlerësim të pasurive, dhe kishte hartuar raportin e përgjithshëm të inventarizimit, mirëpo të njëjtin nuk e kishte harmonizuar me regjistrin kontabël para përgatitjes së PFV-ve;<br><br>Pagesat për shpronësim e tokës[12] nuk ishin evidentuar në regjistrat e pasurisë dhe nuk ishin shpalosur në PFV, duke i nënvlerësuar pasuritë kapitale për 310,809€; | komunës (përfshirë pasuritë kapitale dhe jo kapitale) janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtim me kërkesat ligjore | | | | |
| 8 | **Çështja B3 – Rritje e vlerës së Llogarive të Arkëtueshme dhe shpalosje jo e saktë e tyre në PFV** | **Gjetja:**<br>Në PFV 2019 janë raportuar LLA nga shfrytëzimi i pronës publike vlera 32,284€, mirëpo pjesa e LLA në vlerë 45,966€ që | Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të sigurojë nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke | Do ti kushtohet rendesi e veqant hartimit te listave apo evidencave te tatimpagueseve borgjlinjë. Kartelat individuale te tyre do te paraqesin nje | Zyra e Kryetarit permes çdo njësie organizative që krijon të hyra. | Janar – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | janë dërguar tek përmbaruesi për inkasim, nuk ishin shpalosur në PFV. Përveç shpalosjes jo të saktë, informatat për shfrytëzimin e pronës publike nuk ishin të plota dhe kishte gabime në bartjen e salldove. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës, dhe nga mungesa e kordinimit të brendshëm në lidhje me lëndët përmbarimore. Përveq shpalosjes jo të saktë në PFV, në krahasim me vitin paraprak LLA kanë pësuar rritje për 80,934€. Kjo rritje ishte kryesisht nga tatimi në pronë, i ndikuar nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të menaxhuara/priva | raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen me një kujdes të veçantë nëpër vite. Çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore duhet të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit/arkëtimit të tyre bazuar në marrëveshjet e arritura me tatimpaguesit. | gjendje te saktë rreth pagesave dhe obligimeve te mbetura. | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit[16]. Megjithatë që nga data 31.12.2019 komuna kishte filluar me aplikimin e masave për inkasim duke dërguar vërejtje për pagesë dhe duke lidhë marrëveshje me tatim paguesit. | | | | | |
| 9 | **Mangësi në prezantimin e obligimeve në PFV** | **Gjetja:** Komuna nuk kishte shpalosur saktë obligimet e papaguara në PFV, duke nënvlerësuar llogarinë për 202,214€, pasi kishte një vendim gjyqësor/përmbarimor të përmbarueshëm, sipas ZKF-së kjo ishte edhe arsyeja e mos shpalosjes. Komuna për vitin 2019 nuk kishte libër protokolli për evidentimin e faturave, asnjë nga | Kryetari duhet të siguroj se të gjitha obligimet e mbetura/papaguara në fund të vitit të raportohen saktë në PFV. | Do te behet paraqitja e obligimeve jo vetem te faturave por edhe te vendimeve te ndryshme gjyqesore. Edhe pse obligimet e parashikuara sipas vendimeve gjyqesore apo kontesteve gjyqesore gjithhemone I kemi paraqitur ne Paasqyrat Vjetore Financiare te pjesa e Obligimeve Kontigjente. | Zyra e Kryetarit përmes Drejtorisë së Financave. | Janar – Dhjetor 2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | faturat e testuara nuk ishte e protokolluar. | | | | | |
| 10 | **Çështja A6- Mos kompletimi i NjAB-së** | **Gjetja:** Rregullore QRK-nr 01/2019[18] neni 5 pika 1.1 përcakton se "Subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7.000.000€) milionë euro të ketë së paku tre (3) auditorë të brendshëm. Në komunë NjAB funksionon me vetëm një auditor/Drejtorin e Njësisë. | Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi. | Bazuar ne limit e lejuar nga MF per pozitat e punes, do te mundohemi qe permes riorganizimit te vendeve te punes, te gjindet edhe ndnje mundesi per pozita te lira per kete qellim. | Zyra e Kryetarit. | Korrik – Dhjetor 2020. | |